



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	29-06-2023	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKPH/KIKU	4969/2023		1/8



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 508/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses sipas Aktgjykimit A.nr.1676/2021 të datës 05.06.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative, të pranuar me dhe Aktgjykimit AA.nr.546/2019, të datës 17.05.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamentit për Çështje Administrative, të pranuar me datë 08.06.2021 ka rishqyrtuar ankesën me numër A02/232/2016 të datës 14.06.2016, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit/Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A02/232/2016 e datës 14.06.2016, e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër 02-16-36682/02 i datës 13.05.2016, i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Gjilanit, si dhe Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 05.04.2016.

A r s y e t i m

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, me kërkesën e datës 18.01.2016, ka kërkuar miratimin nga Ministria e Administratës Publike në DASHC/MAP, për shpalljen e konkursit për vendin e punës „Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë“-AR/530/JP00017230. Ndërsa me datën 22.02.2016 DASHC/MAP, Komunës së Gjilanit, ka lëshuar aprovimin për shpalljen e konkursit për vendin e lirë të punës „Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë“, i cili është publikuar me datën 25.02.2016, dhe është vazhduar edhe shtatë (7) ditë me njoftimin e datës 14.03.2016 me numër protokollit 02-061-23867.

Ankuesja, [redacted] me datën 02.03.2016, ka aplikuar në konkursin e shpallur të datës 25.02.2016, për vendin e lire të punës „Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë”, në Komunën e Gjilanit. Komisioni përzgjedhës me datën 05.04.2016 me numër protokolli 231, ka dhënë rekomandimin përfundimtar lidhur me procedurën e rekrutimit, ndërsa Komuna e Gjilanit me datën 06.04.2016 ka publikuar përzgjedhjen përfundimtare me numër protokolli 061-3172.

Ankuesja e pakënaqur me përzgjedhjen përfundimtare të Komisionit Përzgjedhës, për pozitën „Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë”, me datë 20.04.2016 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 02-016-36682 në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, në Komunën e Gjilanit, me pretendimet ankimore kundër përzgjedhës dhe zhvillimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit me datë 13.05.2016 ka nxjerr vendimin me numër 02-016-36682/02 me të cilin e refuzon si të pabazuar ankesën e ankueses

Ankuesja [redacted] e pakënaqur me Vendimin numër 02-016-36682/02 të datës 13.05.2016 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Gjilanit, ka parashtruar ankesë me datën 14.06.2016 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendim ankimore kundër Vendimit të datës 13.05.2016 me numër 02-016-36682/02 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 15.06.2016, kërkesën për përgjigje në ankesë e ka proceduar tek Komuna e Gjilanit, ndërsa me datë 30.06.2016 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Gjilanit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe (1/104).

[redacted] kandidatja e përzgjedhur në vendin e punës „Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Lartë”, në Komunën e Gjilanit, me datë 29.07.2016, ka ofruar provë shtesë „Diplomën me numër 1144 të datës 31 tetor 2006 për mbarimin e Shkollës së Lartë Pedagogjike-Dega Mësim Klasor-Universiteti i Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 10.08.2016 përmes emailit ka kërkuar informatë zyrtare nga komuna e Gjilanit nëse [redacted] kandidatja e përzgjedhur në vendin e punës „Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Lartë”, në Komunën e Gjilanit, ka dorëzuar dëshmi „Diplomën me numër 1144 të datës 31 tetor 2006 për mbarimin e Shkollës së Lartë Pedagogjike-Dega Mësim Klasor në Universitetin e Prishtinës, me të cilin ka fituar titullin „Arsimtare e Mësimi Klasor me datë 20.05.2002” në konkursin e publikuar të datës 25.02.2016 për pozitën „Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Lartë”, ndërsa me datë 11.08.2016, Këshilli po ashtu përmes emailit ka pranuar fotokopjen e Diplomës me numër 1144 të datës 31 tetor 2006 për mbarimin e Shkollës së Lartë Pedagogjike-Dega Mësim Klasor në Universitetin e Prishtinës për kandidaten nga Komuna e Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 11.08.2016 ka marr vendim me A02/232/2016, me numër protokolli 3205/2016, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi Vendimin me numër 02-16-36682/02 të datës 13.05.2016 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Gjilanit.

Ankuesja [redacted] e pa kënaqur me vendimin me numër A/02/232/2016 të datës 11.08.2016 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 09.07.2016 ka hapur konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 18.01.2018 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1369/2016 me të cilin e ka refuzuar kërkesë padinë e paditëses si e pa bazuar.

Ankuesja e pa kënaqur me Aktgjykimin me numër A.nr.1369/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 26.02.2018 ka parashtruar ankesë pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, ndërsa kjo e fundit me datën 21.02.2019 ka nxjerr Aktgjykimin me numër AA.nr.123/2018 me të cilën e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditëses, duke e anuluar Aktgjykimin me numër A.nr.1369/2016 të Gjykatës Themelore / Departamenti për Çështje Administrative dhe lenden e kthehen në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative me datë 28.05.2019 sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në rishqyrtim dhe rivendosje, përsëri e refuzon kërkesë padinë e paditëses si të pa bazuar, ndërsa ankuesja e pakënaqur me Aktgjykimin me numër A.nr.530/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative me datë 21.06.2019 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, ndërsa kjo e fundit me datën 08.06.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër AA.nr.546/2019 përmes të cilit e ka aprovuar ankesën e paditëses duke e anuluar Aktgjykimin me numër A.nr.530/2019 të datës 28.05.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë / Departamenti për Çështje Administrative, si dhe e ka anuluar Vendimin me numër A/02/232/2016 të datës 11.08.2016 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Këshilli.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 08.06.2021 ka pranuar Aktgjykimin me numër AA.nr.546/2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/ Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa me datë 07.07.2021 për mes njoftimit me numër protokollit 115/2019 e ka njoftuar ankuesen lidhur me rrethanat e krijuara në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, gjegjesisht është njoftuar për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës për shkak të mungesës së kuorumit për të shqyrtuar dhe vendosur sipas Aktgjykimit me numër AA.nr.546/2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke e udhëzuar që pala mund të fillon konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Ankuesja me datë 27.07.2021 ka vazhduar me inicimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 05.06.2023 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr. 1676/2021, me numër protokollit 4759/2023, me të cilin Aktgjykimin e ka anuluar Njoftimin e datës 07.07.2021 dhe ka detyruar të njëjtin që të vendos sipas Aktgjykimit me numër AA.nr.546/2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/ Departamenti për Çështje Administrative të datës 08.06.2021

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr. 1676/2021, i datës 05.06.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative të pranuar në Këshill me datë 15.06.2023 me numër protokollit 4759/2023; Aktgjykimin me numër A.nr.1369/2016 i datës 18.01.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-

Departamentin për Çështje Administrative i pranuar me date 02.02.2018; Aktgjykimin me numër AA.nr.123/2018 i dates 21.02.2019 i Gjykatës se Apelit te Kosovës/ Departamenti për Çështje Administrative, i pranuar ne Keshill me datë 08.03.2019 me numër protokolli 1272/2019; Aktgjykimin me numër A.nr.530/2019 i datës 28.05.20219 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative të pranuar ne Keshill me datë 27.06.2019 me numër protokolli 2872/2019; Aktgjykimin me numër AA.nr.546/2019 të datës 08.06.2021 të Gjykatës se Apelit te Kosovës/ Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me numër 02/232/2016 të datës 14.06.2016 në KPMSHCK; Ankesën e datës 20.04.2016, me numër protokolli 02-016-36682 në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesa; Vendimi i datës 13.05.2016 me numër 02-016-36682/02 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Procesverbali i datës 05.05.2016 (fletedorzimi) i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesa për fillimin e rekrutimit ForMAP-SHCK-01; Autorizimi nga DASHC/MAP i datës 22.01.2016; Njoftimi i datës 14.03.2016 me numër protokolli 02-061-23867, për vazhdim të konkursit; Kopje e konkursit publik e datës 25.02.2016; Vendimi i datës 17.03.2016 nr.190 i komisionit përzgjedhës; Regjistri i aplikacioneve for.MAP-SHCK-04; Raporti nga komisioni përzgjedhës lidhur me listën e ngushtë i datës 23.03.2016; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 23.03.2016 FormMAP-SHCK-05; Rregullat e Testit me shkrim i datës 29.03.2016; Kopja e testit me shkrim i datës 29.03.2016; Njoftimi i kandidatëve për testim nga përzgjedhja e ngushtë i datës 24.03.2016 FormMAP-SHCK-06; Përcaktimi i kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj Form.MAP-SHCK-07a; Vlerësimi individual i kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj Form.MAP-SHCK-08a; Përmbledhja e vlerësimeve individuale Form.MAP-SHCK-09; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga testi me shkrim dhe me gojë 01.04.2016 Form.MAP-SHCK-10; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 04.04.2016 Form.MAP-SHCK-11; Vendimi datës 05.04.2016 Nr.231 për aprovimin e rekomandimit të komisionit përzgjedhës të shërbyesve civil; Njoftimi i datës 05.04.2016 për kandidatin e suksesshëm; Kërkesa për punësim e datës 10.03.2016; Kërkesa për punësim e datës 03.03.2016; Provat shtesë: Diplomën me numër 1144, të datës 31.10.2006 për mbarimin e Shkollës se Larte Pedagogjike-Dega Mësim Klasor në Universitetin e Prishtinës; Vërtetim me numër protokolli 121/2016 te lëshuar nga The Cambridge School, i datës 02.03.2016; Vërtetim me numër protokolli 05-061-22433 te lëshuar nga Drejtoria e Arsimit-Komuna e Gjilanit, i datës 09.03.2016; si dhe përgjigja e datës 30.06.2016 në ankesë nga organi i punësimit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës(1/104).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses Nebahate Morina, e cila pretendon se Komisioni Përzgjedhës me rastin e përzgjedhjes së kandidate së suksesshme për vendin e punës " *Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë*"" , në Komunën e Gjilanit, nuk ka vlerësuar drejtë përgaditjen profesionale dhe përvojën e punës sipas kriterëve të konkursit, dhe njëkohësisht pretendon se Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjilanit, është nxjerrë në kundërshtim me ligjet dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit të shpallur nga Komuna e Gjilanit të datës 25.02.2016, për pozitën „Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë“, kanë qenë:

- Diplomë Universitare të profilit arsimor;
- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Komuna e Gjilanit, me datë 25.02.2016 ka shpallur konkursin për vendin e lirë të punës „Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë“-AR/530/JP0001723“, pasi ka pranuar aprovimin e datës 22.02.2016 nga Ministria e Administratës Publike/DASHC, ndërsa me datë 17.03.2016 është themeluar Komisioni Përzgjedhës prej pesë (5) anëtarëve për pozitën e punës „Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë“, në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 i Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Tutje Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, më datë 22.03.2016 ka përgatitur listën e shkurtër brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 26 të Rregullorës Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *“Përgatitja e listës së shkurtër zhvillohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas afatit të fundit të përcaktuar në shpalljen e rekrutimit”*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Shërbimit Korrektues të Kosovës, poentimin e kandidatëve për listë të ngushtë për Konkursin lidhur pozitën e punës *“Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë”*, e ka bërë në pajtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilën janë të përcaktuar kriteret për përfshirje në listën e ngushtë ku përcaktohet se: *“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathtësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës”,.... secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura të tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes”*, andaj në rastin konkret Kolegji konstaton se në listën e ngushtë është përfshirë ankuesja dhe dy kandidatë tjerë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pas analizimit të provave të lëndës, konstatoi se Komisioni Përzgjedhës për konkursin lidhur me pozitën e punës *“Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë”*, testin me shkrim e ka përpiluar në pajtim me Nenin 36 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 dhe nën paragrafin 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri në përzgjedhjen përfundimtare, duke bërë vlerësimet e testit me shkrim dhe vlerësimet e intervistës me gojë si për ankuesen, po ashtu edhe për kandidaten e përzgjedhur ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankueses i'u referua nenit 40 paragrafi 1, 2 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë, pikët e përgjithshme në testin me shkrim dhe me gojë mbledhen dhe përpjesëtohen për dy, Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pakë se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara”*,

andaj konstatohet se Komisioni Përzgjedhës për Konkursin lidhur me pozitën e punës "Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë", me përzgjedhjen e kandidatës M.H ka vepruar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, pasi që në bazë të vlerësimeve kandidatja e përzgjedhur ka arritur gjithsejtë 408 nga pikët e përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, ndërsa ankuesja është N.M renditur e dyta me gjithsejtë 274 pikë të përgjithshme në renditjen përfundimtare të kandidatëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, konstatoi se Komisioni Përzgjedhës I Konkursit lidhur me pozitën e punës „Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë“, me përzgjedhjen e kandidatës M.H pas realizimit të gjithsejtë 408 pikë duke u renditur e para në renditjen përfundimtare, ka vepruar drejtë dhe në pajtueshmëri me Nenin 2 paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovë ku përcaktohet se: „Merita - veçantia e cila krijon të drejtën e punësimit të një kandidati në një pozitë në shërbimin civil pas përfundimit të suksesshëm të procedurës konkurruese të përzgjedhjes dhe e cila i jep nëpunësit civil të drejtën e avancimit në karrierë, në bazë të rezultateve të dëshmuara gjatë ushtrimit të detyrave administrative“.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marrë për bazë vërejtjet dhe sygjerimet e dhëna nga Gjykata e Apelit me Aktgjykimin me numër AA.nr. 546/2019 të datës 08/06/2021, se Këshilli duhet të vlerësoj përvojën e punës së kandidatës së përzgjedhur si dhe kualifikim profesional të saj, Këshilli pas administrimit të provave ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur me datë 29.07.2016, ka dorëzuar ofruar provë shtesë-dëshmi „Diplomën me numër 1144 të datës 31 tetor 2006 për mbarimin e Shkollës së Lartë Pedagogjike-Dega Mësim Klasor në Universitetin e Prishtinës, me të cilin ka fituar titullin „Arsimtare e Mësimit Klasor me datë 20.05.2002“, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 10.08.2016 përmes e-mailit ka kërkuar informatë zyrtare nga komuna e Gjilanit nëse

kandidatja e përzgjedhur në vendin e punës „Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Lartë“, në Komunën e Gjilanit, ka dorëzuar si dëshmi „Diplomën me numër 1144 të datës 31 tetor 2006 për mbarimin e Shkollës së Lartë Pedagogjike-Dega Mësim Klasor në Universitetin e Prishtinës, me të cilin ka fituar titullin „Arsimtare e Mësimit Klasor me datë 20.05.2002“ në konkursin e publikuar të datës 25.02.2016 për pozitën „Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Lartë“, ndërsa ky fakt është konfirmuar përmes e-mailit me date 11.08.2016, nga Komuna e Gjilanit-Zyra e Burimeve Njerëzore të cilët në Këshill kanë dorëzuar fotokopjen e Diplomës me numër 1144 të datës 31 tetor 2006 për mbarimin e Shkollës së Lartë Pedagogjike-Dega Mësim Klasor në Universitetin e Prishtinës për kandidaten

andaj bazuar në këtë sqarim zyrtarë Kolegji konstaton se përgatitja profesionale është konformë kriterëve të konkursit, dhe se pretendimet ankimore të ankueses lidhur me përgatitjen profesionale të kandidatës së përzgjedhur në vendin e lirë të punës Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Lartë“, në Komunën e Gjilanit, janë të pabazuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me shumicë të votave, konstatoi se kandidatja e përzgjedhur në vendin e punës „Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Lartë“, ka plotësuar kriterin e kërkuar sipas konkursit të shpallur gjegjësisht kriterin e përvojës së punës profesionale pas diplomimit sepse kandidatja e përzgjedhur ka përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike ku sipas Diplomës me numër 1144 të datës 31.10.2006 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Shkolla e Lartë Pedagogjike dëshmohet se me datë 22.05.2002, ka marrë kualifikim "Arsimtar i Mësimit Klasor". Po ashtu edhe me Certifikatën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" të datës 25.06.2015, Këshilli vëren se kandidatja, i ka kryer të gjitha provimet e parapara në studimet themelore në Programin Fillor studimet katërvjeçare si student i Programit-

Avancimi i Kualifikimit te Mësimdhënësve dhe në këtë kuptim e njëjta i ka plotësuar kushtet e konkursit lidhur me përgatitjen profesionale, sepse ky shkollim është shkollim Universitar dhe përvoja e punës pas kryerjes se shkollimit universitar konsiderohet përvojë profesionale e punës. Po ashtu Këshilli konstaton se kandidatja e përzgjedhur e ka plotësuar edhe kriterin e përvojës së punës nga se e njëjta me vërtetimin e lëshuar nga Komuna e Gjilanit të datës 09.06.2016, dëshmohet se nga data 04.09.2014 deri me datën 09.03.2016 kur është lëshuar vërtetimi ka punuar në kuadër të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Gjilanit. Gjithashtu edhe me vërtetimin e lëshuar nga „The Cambrige School” nga Prishtina të datës 02.03.2016, vërteton faktin se e njëjta ka punuar si Menaxhere e kësaj Shkolle në degën në Gjilan që nga muaji Maj 2002 e deri me datë 03.09.2014, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në dëshmitë e ofruara Kolegji konstaton se kandidatja e përzgjedhur nga data e diplomimit respektivisht nga data 22.05.2002 deri në ditën kur ka aplikuar, ka gjithsejtë mbi dymbëdhjetë (12) përvojë pune pas diplomimit, që nënkupton se e njëjta/apo kandidatja e përzgjedhur e ka plotësuar kriterin e përvojës se punës të përcaktuara sipas konkursit të datës 25.02.2016, të shpallur nga Komuna e Gjilanit, për vendin e lirë të punës „Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë”-AR/530/JP0001723” i cili kanë qenë: „ Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale’ dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankuseses është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit të gjitha provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës pranë Komunës së Gjilanit, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Lartë” në Komunën Gjilanit, që nga shpallja publike e konkursit më datën 25.02.2016 e deri në njoftimin e kandidatës së përzgjedhur, ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton që: „Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve” dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton që: „Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”, si dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Gjilanit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.02-16-36685/02 të datës13.05.2016, ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, se ka arritur të vërtetoj gjendjen faktike dhe bazën juridikë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, me shumice të votave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave, të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Anëtari i Kolegjit i cili ka dhënë mendim mospajtues me këtë vendim, duhet të jap me shkrim mendimin mospajtues dhe i njëjti duhet t’i bashkëngjitet dosjes së lëndës.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konflikt administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.508/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Gjyqtares Gjkata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.